



Banka e Shqipërisë

Sistemi i Klerimit të Pagesave me
Vlerë të Vogël (AECH)

Manual i Përdoruesit

PËRMBAJTJA

SEKSIONI A SISTEMI ELEKTRONIK SHQIPTAR I KLERIMIT TË PAGESAVE

Kapitulli I. Sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH)

1	Tiparet kryesore	6
2	Sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël	6
2.1	Komponentët	6
3	Sistemi AECH qendror	6
4	Sistemi AECH i pjesëmarrësit	7
4.1	<i>Workstation</i>	7
4.2	Komponentët	7
4.3	Nënshkrimi i <i>file-eve</i> - Çertifikata dixhitale	8
5	Llogaritë teknike	9
6	Instruksionet e pagesave në sistemin AECH	9
6.1	Urdhër pagesa me vlerë të vogël(UPVV)	9
6.2	Debitimi Direkt (DD)	9
7	Seancat e kleringut - UPVV	10
7.1	Struktura e një seance kleringu	10
7.2	UPVV me datë të ardhshme	11
8	Procesi i klerimit – DD	11
8.1	Dërgimi i <i>file-eve</i>	11
8.1.1	Dërgimi ndaj klerimit dhe shlyerjes	11
8.1.2	<i>Cut –off</i> i Debitimit Direkt	12
8.1.3	Instruksione pagesash DD me datë valute të ardhshme	12
8.1.4	Refuzimet e <i>file-eve</i> të DD	12
8.1.5	Periudha pritëse e refuzimeve të DD	12
8.2	Kleringi i <i>file-eve</i> të instruksioneve të pagesave DD.....	12
9	<i>Batch-et, file-et</i> dhe instruksionet e pagesave.....	13
9.1	Autorizimi dhe autenticiteti.....	13
9.2	ID e <i>batch-it</i>	14
9.3	Emrat e <i>file-eve</i> për <i>file-et</i> e transferuar	14
9.4	Mesazhet e sistemit dhe njoftime lidhur me transmetimin e <i>file-eve</i>	14
9.5	Referencat e transaksionit në llogarinë AECH.....	15
9.6	Pakthyeshmëria e instruksioneve të pagesave	15
10	Orari Operues të sistemit AECH	16
11	Instrumentet e raportimit	17
11.1	Paraqitja e raporteve	17
11.2	Dërgimi i raporteve	18
12	Gjurmët e kontrollit / auditit.....	18

KAPITULLI II. Pjesëmarrja në sistemin AECH

1	Pjesëmarrja	20
1.1	Kërkesat për pjesëmarrje	20
1.2	Kërkesat teknike	20
1.3	Kategoritë e pjesëmarrjes.....	21
2	Përfundimi i procesit të pjesëmarrjes.....	21
2.1	Aplikimi për pjesëmarrje, formulari i pjesëmarrjes.....	21
2.2	Nënshkrimi i kontratës së pjesëmarrjes	21

KAPITULLI III. Tarifat dhe Gjobat

1	Tarifat	22
2	Gjobat	23

KAPITULLI IV. Procedura në situata jonormale

1	Përcaktimi i ngjarjeve të paparashikuara	24
2	Procedurat për administrimin e ngjarjeve të paparashikuara	24
3	Komunikimi i ngjarjeve të paparashikuara	26
4	Zbulimi dhe raportimi i ngjarjeve të paparashikuara	26
5	Raportimi i ngjarjeve të paparashikuara	26

Aneks A.1

Parametrat e sistemit.....	28
----------------------------	----

Aneks A.2

Formularët e mesazheve SWIFT.....	29
-----------------------------------	----

Aneks A.3

Fazat e anëtarësimit.....	32
---------------------------	----

Aneks A.4

Formulari për pjesëmarrje në sistemin AECH.....	35
---	----

Aneks A.5

Kontrata tip.....	36
-------------------	----

Aneks A.6

Regjistrimi i ngjarjeve të paparashikuara	42
---	----

SEKSIONI B

MANUALI PËR KLERIMIN E ÇEQEVE

1	Baza ligjore për klerimin e çeqeve	44
2	Organizimi i klerimit të çeqeve në lek	44
2.1	Seanca e klerimit të çeqeve	44
2.1	Pjesëmarrja në seancën e kleringut	44
2.3	Përgatitja e dokumenteve para seancës	44
3	Procedura për klerimin e çeqeve në lek	45
3.1	Funksionimi i seancës së kleringut	45
3.2	Rezultatet dhe mbyllja e seancës së kleringut	45
4	Shlyerja e rezultateve të seancës së kleringut në sistemin AIPS	45
5	Përgjegjësi nga përgjegjësia	46

Aneks B.1

Formulari i kërkesës për anëtarësim.....	47
--	----

Aneks B.2

Formulari për dërgimin e çeqeve në lek në klering.....	48
--	----

Aneks B.3

Formulari i kleringut të çeqeve.	49
---------------------------------------	----

Aneks B.4

Instrukcioni i Shlyerjes Neto	50
-------------------------------------	----

Aneks: Manuali i përdoruesit për pjesëmarrësin*

* Manuali Teknik i Përdoruesit për pjesëmarrësit në sistem nuk është për përdorim të përgjithshëm publik, por i jepet çdo Pjesëmarrësi të çertifikuar në sistem.

SEKSIONI A

SISTEMI ELEKTRONIK SHQIPTAR I KLERIMIT TË PAGESAVE

KAPITULLI I

SISTEMI I KLERIMIT TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL (AECH)

1. Tiparet kryesore

AECH është sistemi elektronik i klerimi-it në të cilin *file-et* me vëllim të madh, të instruksioneve të pagesave me vlerë të vogël (si transfertat e kreditimit dhe debitimet direkte) këmbehen ndërmjet bankave dhe Institucioneve të tjera kredituese. *File-et* me transfertat kredituese dërgohen tek bankat marrëse vetëm pasi pozicionet neto (që rezultojnë nga këmbimi i *file-eve*) të jenë shlyer nëpërmjet sistemit AIPS (Sistemi i Pagesave Ndërbankare me Vlerë të Madhe). *File-et* me instrumente debitimi dërgohen më herët në sistem për të mundësuar refuzimin e mundshëm të *item-ve* (pagesave). *File-et* këmbehen nëpërmjet shërbimit SWIFTNet FileAct.

AECH zotërohet dhe administrohet nga Banka e Shqipërisë.

2. Sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH)

2.1 Komponentët

Sistemi AECH përbëhet nga:

- Sistemi qendror i klerimit (sistemi AECH qendror), i cili administron pozicionet neto të pjesëmarrësve, pasi *file-et* e instruksioneve të pagesave janë marrë dhe dërguar gjatë seancave të kleringut, dhe më pas i shlyen pozicionet në fund të çdo seance nëpërmjet sistemit AIPS.
- Sistemi AECH pjesëmarrës, i cili funksionon në Drejtoritë Qendrore të çdo Pjesëmarrësi, mund të funksionojë edhe në degë, duke u mundësuar pjesëmarrësve që të përgatisin *file* për procesim, dhe të dërgojnë e të marrin *file* nga sistemi AECH qendror.

3. Sistemi AECH qendror

Sistemi AECH qendror ashtu si dhe sistemi AIPS në Bankën e Shqipërisë mund të operojnë në site-in “primar” dhe në atë “backup”.

Sistemi AECH qendror administron:

- Ciklin ditor të seancave të kleringut dhe mirëmbajtjen e sistemit AECH;
- Vlefshmërin dhe pranimin e *file-eve* të instruksioneve të pagesave të dërguara nga Sistemi AECH pjesëmarrës;
- Dërgimin e njoftimeve të pranimit të *file-eve* tek pjesëmarrësit;
- Llogaritjen, *file* me *file*, të pozicioneve neto, për llogaritë teknike të sistemit AECH;
- Refuzimet e Debitimeve Direkte;
- Krijimin e Instruksioneve të Shlyerjeve Neto (*NSI*) në fund të çdo seance kleringu dhe dërgimin e *NSI-ve* në sistemin AIPS;
- Dërgimin e *file-eve* të instruksioneve të pagesave tek Pjesëmarrësit marrës;
- Raportet për administratorët/drejtuesit dhe për Pjesëmarrësit.

BSH-ja, në cilësinë e pronarit dhe të operuesit të sistemit, përdor sistemin AECH qendror për të kryer funksionet e saj të administrimit të sistemit.

BSH-ja kryen dy tërësi funksionesh, të cilat janë:

- Administrimin e Sistemeve;
- Pjesëmarrjen në sistemin AECH për të dërguar dhe marrë *file*.

Funksionet e administrimit të sistemeve kryhen nëpërmjet aksesit të tipit *browser-based* në sistemin AECH qendror, i cili siguron të gjithë funksionet e nevojshme për të operuar, monitoruar dhe kontrolluar sistemin AECH qendror. Gjithashtu, BSH-ja mund të ndjekë ecurinë e *file-eve* të saj të instruksioneve të pagesave duke përdorur funksionet e kërkimit të të dhënave dhe të kontrollit të sistemit AECH qendror si çdo pjesëmarrës tjetër.

Pjesëmarrësit mund të aksesojnë sistemin AECH qendror për qëllime kërkimi nëpërmjet VNP-së dhe mund të monitorojnë veprimet e tyre në sistemin AECH në çdo kohë (përfshirë të dhëna financiare dhe statusin e të gjithë mesazheve dhe transaksioneve).

4.Sistemi AECH pjesëmarrës (PS)

4.1 Workstation

Sistemi AECH pjesëmarrës (PS) është projektuar për të vepruar në kompjutera personalë standardë (Kompjutera tavoline (desktop) dhe/ose Laptop) që kanë sistemin operues *Windows* (shihni Dokumentet për kërkesat teknike të sistemit AECH të pjesëmarrësit). Pjesëmarrësit do të ndërfaqësohen me sistemin AECH qendror nëpërmjet VNP-së duke përdorur një *browser* interneti standard.

Gjithashtu, pjesëmarrësi përdor shërbimin SWIFTNet FileAct për të transferuar *file* nga PS në zyrat e tyre qendrore tek sistemi AECH qendror. Disa degë me vëllime të mëdha pagesash në AECH mund të përdorin gjithashtu SWIFTNet FileAct për transferimin e drejtpërdrejtë të *file-eve* për tek sistemi AECH.

Megjithatë, *file-et* e përgatitur në degë, normalisht transferohen tek AECH nëpërmjet PS në drejtoritë qendrore të pjesëmarrësit. Transferimi i *file-eve* nga PS në një degë

tek PS në drejtoritë qendrore të pjesëmarrësit kryhet nëpërmjet mekanizmave të veta të transferimit të *file-eve* të pjesëmarrësit (shih Pikën Nr.9).

4.2 Komponentët

Sistemi AECH pjesëmarrës siguron lehtësira për përgatitjen dhe dërgimin e *file-eve* në direktori lokale, prej ku ato merren nga SWIFTNet dhe dërgohen tek sistemi AECH qendror.

Sistemi i pjesëmarrësit (PS) përbëhet nga dy komponent të dukshëm për përdoruesin:

- Elementi *browser* standard, i cili është ndërtuar në sistemin operues *Windows*;
- Programi AECH PS, i instaluar veçmas në serverin e sistemit AECH ose një PC *workstation*, në vendndodhjen e pjesëmarrësit, i cili siguron funksionet e operimit të *item-ve*, *file-eve* dhe *batch-eve*.

Sistemi AECH PS përgatit *file* që përmbajnë *batch-e* pagesash dhe nënshkruan në mënyrë dixhitale *batch-et*, qoftë nën kontrollin e përdoruesit ose nëpërmjet importit të *file-eve* nga aplikimet ekzistuese të një pjesëmarrësi për procesim STP (*Straight Throgh Processing*).

Programi PS mund të ngarkohet në çdo numër *worksations*, ose të aksesohet në server nga përdorues të shumtë. Kështu që një numër PS-shë mund të jenë në përdorim në të njëjtën kohë për përgatitjen e *file-eve*. Megjithatë, *file-et* e përgatitur duhet të gjithë të vendosen në një direktori të caktuar të aksesueshëm nga SWIFTNet në LAN e pjesëmarrësit.

Programi PS i mundëson përdoruesit të:

- Hedhë *items* instruksionesh pagesash në ekran;
- Identifikojë dhe përzgjedhë *file* (të krijuar nga sisteme të tjera të brendshme për pjesëmarrësit), të cilët duhet të importohen në mjedisin e sistemit AECH;
- Kontrollon formatin e *file-it* të importuar (kontrolli i sintaksës);
- Përgatisë *batch-et* e instruksioneve të pagesave, të grupuar në *file*, duke i përzgjedhur dhe/ose renditur në qoftë se nevojitet, dhe nënshkruar;
- Dërgojë *file* në një *outgoing folder* për t'i transferuar tek sistemi AECH qendror.

4.3 Nënshkrimi i *file-ve* – Çertifikata dixhitale

File-t e krijuara në PS renditen automatikisht në *batch-e* sipas llojit të instrumentit, datëvalutës dhe bankës marrëse. Çdo *batch* brenda një *file* nënshkruhet në mënyrë dixhitale duke përdorur certifikatën dixhitale të serverit të pjesëmarrësit. Certifikata e përdorur për të nënshkruar *batch-in* ndërfutet tek *batch-i* pas nënshkrimit, në mënyrë që të përfshihet pas përlogaritjes të totalit të nënshkrimit dixhital.

Më pas, *file-t* dërgohen në sistemin AECH qendror nëpërmjet SWIFTNet FileAct, ku çdo *batch* përpunohet veçmas dhe, në qoftë se pranohet për shlyerje, dërgohet tek banka marrëse përkatëse.

Në sistemin AECH qendror dhe në bankat/degët marrëse përmbajtja e *batch-it* dhe nënshkrimi dixhital kontrollohen automatikisht për të verifikuar saktësinë e

nënshkrimit dixhital dhe vlefshmërinë e certifikatës dhe lëshimin nga një Autoritet Certifikues i besuar (që është Banka e Shqipërisë)*.

* Certifikata dixhitale është një certifikatë e gjeneruar në serverin e autoritetit certifikues. Kjo certifikatë përdoret për të nënshkruar *batch*-et me pagesa. Për çdo pjesëmarrës, gjenerohet një certifikatë dixhitale unike.

5. Llogaritë teknike

Çdo pjesëmarrës, përfshirë Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave, ka një "llogari teknike" në sistemin AECH (këto nuk janë "llogari" në kuptimin e mirëfilltë të fjalës në kontabilitet).

Llogaria teknike përdoret për të llogaritur dhe pasqyruar pozicionet neto shumëpalëshe të një pjesëmarrësi që mund të ndryshojnë pas çdo *batch*-i të miratuar gjatë një seance kleringu. Më poshtë në pikën e seancave të kleringut, shpjegohet një seancë kleringu (shih Pikën Nr.7.1 të këtij Manuali).

Llogaria teknike është gjithmonë zero në fillim dhe në fund të seancës së kleringut.

6. Instruksionet e pagesave në sistemin AECH

6.1 Urdhërpagesa me vlerë të vogël

Një urdhërpagesë me vlerë të vogël (UPVV) është një instruksion pagese iniciuar nga një pagues për të debituar llogarinë e tij dhe për të kredituar llogarinë e një përfituesi, domethënë një transfertë kreditimi. Një UPVV ka një vlerë maksimale të përcaktuar në Rregulloret për sistemin AECH (shih Aneksi A.1).

UPVV përmban të gjithë informacionin e kërkuar sipas rregulloreve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me pjesëmarrësin/pjesëmarrësit dhe klientët e tyre të përfshirë në transfertën e kreditimit. (shih Aneksi A.2).

Në sistemin AECH, *file-t* që përmbajnë *batch*-e të nënshkruara në mënyrë dixhitale të UPVV-ve, transferohen elektronikisht nga pjesëmarrësi porositës në sistemin AECH duke përdorur SWIFTNet FileAct. Çdo *batch* është caktuar për një përfitues të veçantë. *Batch*-et (që mbartin nënshkrimin dixhital origjinal), të verifikuar nga sistemi AECH, grumbullohen nga pjesëmarrësi përfitues pas shlyerjes së pozicioneve neto në sistemin AIPS, në fund të një seance kleringu në sistemin AECH.

6.2 Debitimi Direkt

Debitimi Direkt (DD) është një instruksion transfertë debitimi (shih Aneksi A.2) iniciuar nga një përfitues për të debituar llogarinë e një klienti të një pjesëmarrësi dhe për të kredituar llogarinë e vet. Aktualisht për vlerën e DD-së ka një kufizim të vendosur në rregulloret për funksionimin e sistemit AECH.

Banka e Shqipërisë zotëron Serverin e Autoritetit Certifikues.

Në sistemin AECH, *file-et* e DD, të nënshkruar në mënyrë dixhitale transferohen nga pjesëmarrësi përfitues tek sistemi AECH nëpërmjet SWIFTNet FileAct, të destinuar për një pjesëmarrës pagues specifik. *File-et* (që kanë nënshkrimin dixhital origjinal)

të validuar nga sistemi AECH, dërgohen tek pjesëmarrësi pagues dhe duhet të pranohen nga pjesëmarrësi pagues për atë kohë sa ata nuk dërgojnë refuzime për instruksione specifike.

File-et e refuzimeve transmetohen nga pjesëmarrësi pagues tek sistemi AECH qendror dhe duhet të merren nga sistemi AECH qendror para një afati kohor specifik (shih Pikën Nr.8.1.5). AECH zbret vlerat e refuzuara nga vlera aktuale e çdo *batch-i* DD të prekur për të llogaritur vlerat e mbetura të detyrueshme për t'u paguar nga pjesëmarrësi pagues.

7. Seancat e kleringut - UPVV

Pjesëmarrësit mund të dërgojnë *file* UPVV në sistemin AECH në çdo kohë, midis fillimit të seancës së parë dhe fundit të pranimit të *file-ve* në seancën e fundit të kleringut të ditës. Megjithatë, pranimi i *file-eve* UPVV tek sistemi AECH qendror ndodh kur miratimi i *file-it* kryhet gjatë seancave të kleringut brenda po asaj dite pune.

Para përfundimit të çdo seance, shlyerja kryhet nëpërmjet sistemit AIPS dhe informacioni i detajuar i kreditimit në *file* i dërgohet pjesëmarrësve përfitues.

7.1 Struktura e një seance kleringu

Tabela e mëposhtme përmbledh një seancë kleringu (shih Pikën Nr.10), sipas periudhave dhe shpjegon çfarë veprimesh lidhen me secilën periudhë. Detaje të veprimeve aktuale të pjesëmarrësit, në lidhje me secilën periudhë jepen në Manualin Teknik, Kapitulli I.

Sistemet e pjesëmarrësit	Sistemet qendrorë
Hapja e aktivitetit	
Fillon dërgimi i <i>file-ve</i> DD tek sistemi AECH qendror. <i>File-et</i> DD mund të dërgohen deri në <i>cut-off</i> . <i>File-et</i> janë: <ul style="list-style-type: none"> • Të importuar, të validuar dhe të listuara nga sistemi AECH pjesëmarrës • Të transferuar në sistemin AECH qendror nga SWIFTNet FileAct • Teknikisht të validuar dhe të marrë nga sistemit AECH qendror për t'u miratuar • Merren njoftime pranimi/refuzimi 	Sistemi AECH qendror kryhen validimin
Fillon Seanca	
Fillon dërgimi i <i>file-eve</i> UPVV tek Sistemi AECH qendror. <i>File-et</i> UPVV mund të dërgohen deri në fund të periudhës së pranimit të <i>file-eve</i> në seancën e fundit të ditës: <i>File-et</i> janë: <ul style="list-style-type: none"> • Importuar, validuar dhe listuar nga Sistemi AECH i pjesëmarrësit • Të transferuar në sistemin AECH qendror nga SWIFTNet FileAct • Të validuar teknikisht dhe të marrë nga sistemi AECH qendror në pritje për t'u miratuar • Merren njoftime pranimi/refuzimi, dhe statusi i pagesës 	<ul style="list-style-type: none"> • Kryhet kleringu i Debitimit Direkt (shih Pikën Nr.8)

Periudha e fillimit të seancës	
Fillon Pranimi i File-ve	
<ul style="list-style-type: none"> Merren njoftime të ndryshimit, miratimit/ refuzimit dhe statusit të pagesës 	<p><i>Batch-et</i> UPVV janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> Të miratuar (ose të refuzuar) nga një përdorues i dytë, nëpërmjet sistemit AECH qendror dërguar në kleringun e sistemit AECH pas miratimit <p>Sistemi AECH qendror kryhen validimin, pas miratimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> Refuzon <i>batch-e</i> nga AECH e pjesëmarrësit ose Pranon <i>batch-e</i> nga AECH e pjesëmarrësit <p>Sistemi AECH qendror bën njoftime të pranimeve ose të refuzimeve për Sistemin AECH pjesëmarrës dhe kalon në klering, për mbledhje nga FileAct.</p> <p>Sistemi AECH qendror ruan <i>batch-et</i> e pranuar dhe përditëson pozicionet neto të pjesëmarrësit urdhërues dhe përfitues.</p>
Përfundon Pranimi i File-ve	
	Përgatitet Instruksioni i Shlyerjes Neto i Sistemit AECH qendror Sistemi AECH qendror nxjerr raportin NSI-Setup
Dërgim i Shlyerjeve Neto	
<ul style="list-style-type: none"> Mund të merren ndryshimet e statusit të pagesës 	<ul style="list-style-type: none"> Sistemi AECH qendror dërgon NSI tek AIPS. AIPS shlyen NSI dhe informon Sistemin AECH qendror Sistemi AECH qendror nxjerr raport shlyerjeje.
Sistemi AECH i pjesëmarrësit i secilës bankë përfituese merr <i>batch-e</i> të kleruar UPVV nga kjo seancë nëpërmjet FileAct	
Fundi i Seancës	
Mund të merren njoftime refuzimi	<ul style="list-style-type: none"> Sistemi AECH qendror përgatit raportet e fundit të seancës, përfshirë raportin e shlyerjes. Në qoftë se nevojitet, një mesazh dërgohet tek AIPS –PACS për shlyerjet BSH - MF. UPVV jo të miratuara në fund të seancës së fundit refuzohen
Sistemi AECH i pjesëmarrësit i çdo banke përfituese merr <i>batche-e</i> të miratuar DD nga kjo seancë nëpërmjet FileAct	

7.2 UPVV me datë të ardhshme

Shënim: Sistemi AECH do të procesojë vetëm *file* UPVV me datëvalutë të ditës aktuale (të sotme). *Batch-et* me datë të ardhshme mund të përgatiten, por duhet të mbahen në PS deri në datëvalutë.

8. Procesi i klerimit – DD

8.1 Dërgimi i *file-eve*

8.1.1 Dërgimi ndaj klerimit dhe shlyerjes

Dërgimi i *file-eve* të Debitimit Direkt (DD) është i ndarë nga procesi i klerimit dhe shlyerja e instruksioneve. *File-et* DD mund të dërgohen gjatë ditës së punës së sistemit AECH pavarësisht seancave të kleringut të UPVV-ve. *Batch-et* DD duhet të dërgohen disa ditë para datë valutës, si parashikohet në rregulloret e sistemit, (shih Aneksi A.1).

Kleringu i *batch-eve* DD të marrë nga sistemi kryhet në fillim të seancës së parë të kleringut në datëvalutë.

Detaje të parametrave për dërgimin DD dhe klerimin jepen si më poshtë.

8.1.2 *Cut-off* i Debitimit Direkt

Rregulloret e sistemit specifikojnë (shih Aneksi A.1) periudhën maksimale të ditëve brenda të cilave mund të dërgohet nga një pjesëmarrës një *file* i instruksioneve të pagesave DD ose refuzime. Dita e fundit është koha e *cut-off* të DD-së, e njohur edhe si *cut-off* i dërgimit.

Dërgimi i *file-ve* DD të pjesëmarrësit (si instruksione pagesash dhe refuzime) mund të kryhet në çdo kohë pas periudhës “hapur për biznes” dhe para *cut-off* të DD-së. *Cut-off* duhet të kryhet pas fundit të seancës përfundimtare të kleringut të UPVV.

8.1.3 Instruksione pagesash DD me datëvalutë të ardhshme

Batch-et e instruksioneve të pagesave DD dërgohen nga pjesëmarrësi përfitues në sistemin AECH qendror. Sistemi AECH qendror ruan *batch-et* dhe i kalon ato tek pjesëmarrësi pagues.

Batch-et e instruksioneve të pagesave DD kanë një datëvalutë të ardhshme në të cilën duhet të klerohen dhe të shlyhen.

Pjesëmarrësi përfitues duhet t'i dërgojë këto *batch-e* DD tek sistemi AECH qendror jo më herët se një numër maksimal ditësh dhe jo më vonë se një numër minimal ditësh para datëvalutës të përcaktuar në rregulloret për funksionimin e sistemit (shih Aneksi A.1).

8.1.4 Refuzimet e *file-ve* të DD

Dërgimi i refuzimeve të *file-ve* të DD kryhet nga pjesëmarrësi tek sistemi AECH qendror. Sistemi AECH qendror ruan refuzimet e *file-ve*, llogarit vlerat e mbetura/tepricën për çdo *batch* DD pas zbritjes së vlerës së refuzuar dhe i kalon ato tek pjesëmarrësi përfitues.

8.1.5 Periudha pritëse e refuzimeve të DD

Rregulloret e sistemit (shih Aneksi A.1) specifikojnë një “periudhë pritjeje” për refuzimet të debitimeve direkte. Kjo është periudhë kohore gjatë të cilës një

pjesëmarrës pagues mund t'i dërgohet një përgjigje negative (në formën e një *file* të refuzuar).

Pikërisht në fund të kësaj periudhe pritëse, AECH llogarit vlerat përfundimtare të mbetura për çdo *batch* DD.

8.2 Kleringu i *file*-eve të instruksioneve të pagesave DD

Procesi i kleringut, në të cilin totaliteti i *batch*-eve të mbetura të instruksioneve të pagesave DD të pjesëmarrësve përfitues netohen në baza shumëpalëshe, kryhet në intervalin ndërmjet fillimit të seancës dhe fillimit të pranimit të *file*-ve UPVV të seancës së parë të kleringut në ditën e datëvalutës së DD.

Rezultatet nga ky proces kleringu përditësojnë pozicionet neto të pjesëmarrësve të përfshirë para fillimit të pranimit të *file*-ve, dhe për rrjedhim, sigurojnë pozicionin startues për dërgimin e *batch*-eve UPVV.

9. *Batche-et*, *file-et* dhe instruksionet e pagesave

Ky pikë përmban informacion të rëndësishëm që ju nevojitet pjesëmarrësve për të njohur *batche-et*, *file-et* dhe instruksionet e pagesave (*item*).

Përgatitja e *file*-eve për procesimin në AECH zhvillohet në sistemin AECH pjesëmarrës në vendndodhjen e pjesëmarrësit. Kjo mund të kryet pa hapur një lidhje me sistemin AECH qendror.

File-et për AECH mund të përgatiten nga:

- *Item* më instruksione pagesash individuale (urdhërpagesa me vlerë të vogël, debitime direkte dhe refuzime të debitimeve direkte) të hedhura në ekran, ose
- *File* ekzistuese me instruksione të pagesave (në format SWIFT FIN ose XML) të importuar në sistemin AECH pjesëmarrës.

File-et mund të dërgohen në sistemin AECH qendror në dy mënyra:

- Nën kontrollin e përdoruesit, *file-et* importohen manualisht në sistemin AECH.
- Nëpërmjet procesit STP (pa ndërhyrje manuale në sistemin AECH pjesëmarrës)

Sistemi i pjesëmarrësit, nëse nevojitet mund të konvertojë *file* nga formati SWIFT FIN MT102, MT103 ose MT104 në formatin xml, të ndara në *batch*-e me instruksione pagesash, duke marrë kodin e bankës dhe datëvalutën, të nënshkruara me firmë dixhitale të pjesëmarrësit dhe t'i ruajë brenda *file*-eve në *Workstation*. *Batch-et* e përgatitur, nënshkruhen në mënyrë dixhitale për të konfirmuar burimin e tyre, për të ruajtur integritetin dhe për të parandaluar mosnjohjen më vonë nga ana e dërguesit. *File-et* që përmbajnë *batch-et*, më pas transferohen në sistemin AECH qendror nëpërmjet SWIFTNet FileAct, dhe miratohen nga një përdorues i dytë për t'u dërguar për klering.

Vini re se, *file-et* e formatit FIN të importuar në sistemin AECH pjesëmarrës duhet të jenë në përputhje me kufizimet të cilat sigurojnë se konvertimi i tyre kryhet në mënyrë korrekte. Këto kufizime shpjegohen në dokumentin për "Kërkesat Teknike të Sistemit" (shih manualin teknik në versionin në gjuhën angleze).

Sipas mënyrës STP, *file-et* e dërguar duhet paraprakisht të renditen dhe në formatin XML, por sistemi AECH pjesëmarrës vlerëson vlefshmërinë e tyre. Sistemi AECH pjesëmarrës në mënyrën STP është programuar për të dërguar këto *file* nga direktoria e specifikuar brenda sistemit origjinues të pjesëmarrësit dhe t'i përgatisë ato për transmetim në AECH qendror. Funkzioni i nënshkrimit dixhital në sistemit AECH pjesëmarrës bën të mundur nënshkrimin në mënyrë dixhitale të këtyre *file-ve*. Nuk ka hap për miratim.

9.1 Autorizimi dhe autenticiteti

File-et e dërguara manualisht nëpërmjet sistemit AECH pjesëmarrës, duhet të përmbajnë një nënshkrim dixhital të pjesëmarrësit dërgues për secilin *batch*. Më pas, *batch-i* duhet të miratohet nga një mbikëqyrës (një miratues) nga banka dërguese. Ky proces i nënshkrimit dixhital dhe miratimi i mëvonshëm, përmbush parimin e praktikës më të mirë "të katër syve" dhe mund të konsiderohet si autorizim i plotë.

Sipas metodës *Straight Through Processing* (STP), *file-t* autorizohen në sistemin origjinues nga pjesëmarrësi në përputhje me politikën dhe praktikën e tyre për të përmbushur rregulloret përkatëse. Në mënyrën STP, nënshkrimi dixhital në PS zbatohet kryesisht për autenticitetin e burimit teknik dhe jo për kthimin e *file-ve*.

9.2 ID e *batch-it*

Kur një *file* importohet në PS, e gjithë struktura e *batch-it* hiqet dhe *item* me instruksionet e pagesës në *file* vihen në listën e *item-ve* të PS.

ID e *batch-it* në dalje/*outgoing* mund të gjenerohet nga sistemi AECH pjesëmarrës ose nga sistemet e brendshme bankare të pjesëmarrësve:

- *File-ve* të importuar në PS nën monitorimin e operatorit, mund t'ju jepet një ID nga përdoruesi, ose PS gjeneron automatikisht një ID unike të *file-it* kur *file-i* në dalje mbledhet dhe ndahet në *batch-e*. *Batche-ve* i jepet në mënyrë automatike një *batch* ID përkundrejt ID së *file* duke shtuar "/n", ku n është numër i plotë që fillon nga 0, për çdo *batch* në *file*. ID e *file-it*, në të cilin *batch-i* është krijuar është gjithmonë *batch* ID me "/n" e hequr.
- *File-et* që dërgohen me STP, *file-et* hyrës/*incoming* do të duhet të përmbajë ID e *batch-it* përkatës.

ID e *batch-it* është i rëndësishëm pasi i mundëson sistemit AECH qendror të sigurojë se një *batch* nuk procesohet më shumë se një herë.

Pjesëmarrësit duhet të kujdesen që, kur punojnë me një PS në vendndodhje të ndryshme, të mos përdorin të njëjtët ID *file* (dhe për pasojë ID *batch-esh*) për *file-t* që vijnë nga më shumë se një vendndodhje. Mund të jetë e vështirë që të bëhet dallimi i tyre më vonë. Këto *file* mund të dallohen vetëm nga ID-të.

9.3 Emrat e *file-eve* për *file-et* e transferuar

Për *file-et* e dërguara nën kontrollin e përdoruesit, *file-et* me instruksionet e pagesave ruhen në direktorinë *outgoing* për t'u mbledhur nga SWIFTNet FileAct.

Sipas rastit, PS mundëson aplikimin e një emër *file-i* alternativ të transmetimit. Emri i këtij *file-i* është ai që shfaqet në raportin *Total File Activity* në AECH.

9.4 Mesazhet e sistemit dhe njoftime lidhur me transmetimin e *file-eve*

Kur *file-et* me instruksione pagesash dërgohen në AECH, mesazhet në lidhje me dërgimin dhe vlefshmërinë e këtyre *file-eve* dhe *batch-eve* brenda tyre, i jepen përdoruesit nëpërmjet SWIFTNet FileAct.

Ato importohen automatikisht në PS, pasi të jenë vendosur nga FileAct në direktorinë përkatëse në serverin e pjesëmarrësit. PS-ja përdor njoftime për të përditësuar statusin e çdo *batch-i* dhe *file-i* në vendet ku janë ruajtur. Këto janë të gjithë të dukshëm duke përdorur funksionet e menysë së PS-së. Kështu, kur ka përfunduar veprimtaria e transmetimit, një përdorues mund të shohë statusin e çdo transaksioni njëherazi si në PS dhe në sistemin AECH qendror. Mesazhet e njoftimit:

- regjistrojnë ndërveprimin që ndodh ndërmjet PS dhe sistemit AECH qendror kur janë dërguar *file-et*,
- kryejnë njoftime të përgjigjeve negative ose pozitive të vlefshmërisë të sistemit AECH Qendror në lidhje me secilin *batch* në çdo *file* të dërguar në AECH; dhe
- sigurojnë përditësime për ecurinë e secilit *batch* gjatë klerimit.

Njoftimet dhe *file-et* e marrë importohen automatikisht në PS, pasi ai është vendosur për të kryer funksionin e importit (të përshkruar në Manualin Teknik të AECH, shiko Pikën Nr.9.4). Kur *file-et* importohen, *batch-et* e marrë ruhen në direktorinë ditorë të administruar nga sistemi. Njoftimet sigurojnë një regjistrim për pjesëmarrësin për të gjithë veprimtarinë e *file-eve*. Detaje të këtyre njoftimeve jepen në Manualin Teknik të AECH, (shiko Pikën Nr.9.6.2).

9.5 Referencat e transaksionit në llogarinë AECH

Pasi ka hyrë në sistemin AECH, çdo *batch-i* i jepet një referencë transaksioni. Kjo sepse vlera totale e çdo *batch-i* që do të shlyhet në fund të seancës përbën një transaksion në AECH, dhe ajo vlerë lidhet me referencën dhe ka mundësi që të gjurmohet gjithmonë në gjurmën e kontrollit.

Si u shpjegua më sipër, *batch-et* e instruksioneve të pagesave klerohen si më poshtë:

- *Batch-et* e instruksioneve të pagesave UPVV klerohen gjatë një seance kleringu, pas fillimit të pranimit të *file-eve* dhe para fundit të pranimit të *file-eve* (periudha e pranimit të *file-eve*), dhe pasi janë shlyer, dërgohen tek pjesëmarrësit para fundit të seancës.
- *Batch-et* e instruksioneve të pagesave DD të mbetura klerohen në fillim të seancës së parë në datëvlerën përkatëse.

Shumat e këtyre *batch-ve* të kleruara regjistrohen në llogarinë teknike AECH si transaksione. Çdo transaksion është i barabartë me:

- Shumën e *batch-it* (totali i *batch*) për instruksione pagesash UPVV;

- Shuma e mbetur e totalit të *batch-it* për instruksione pagesash DD – domethënë shuma origjinale minus çdo refuzim.

9.6 Pakthyeshmëria e instruksioneve të pagesës

Pasi janë dërguar në sistemin AECH dhe janë miratuar, *batch-et* nuk mund të anulohen dhe as të tërhiqen. Megjithatë, instruksionet e pagesës janë të pakthyeshme vetëm pasi AIPS shlyen NSI(Instruksionin e Shlyerjes Neto). Statusi juridik i instruksioneve të pagesave gjatë procesimit në sistemin AECH shpjegohet në rregulloret e sistemit (shih Rregulloren Nr. 55 datë 26/09/2007, Neni Nr.13).

10. Oraret operues të sistemit AECH

Ora	Ngjarja	Operacionet dhe funksionet e mundshme
08:20	Hapur për aktivitet	Fillimi i ditës së punës në sistemin AECH
08:20	Fillimi i seancës së parë të kleringut	Kryhet klerimi i <i>batche-ve</i> të debitimeve direkte për datëvalutën aktuale. Pozicionet neto të rezultuara konsiderohen si pozicione fillestare për seancën
08:35 14:45	Kleringu i <i>file-ve</i> me urdhërpagesa të iniciuara nga Ministria e Financave	Sistemi AECH pranon file me urdhërpagesave të dërguar në formë elektronike nga Ministria për shlyerje në llogarinë kryesore të Qeverisë. Ministria dërgon <i>file-et</i> e urdhërpagesave në oraret e rëna dakord paraprakisht (09:30 – 12:00 – 14:00), këto orare mund të ndryshojnë duke njoftuar pikat e kontaktit. <i>File-et</i> me urdhër pagesa validohen, dhe në rast gabimi, AECH PS e MF gjeneron listën elektronike për pagesat me <i>errore</i>
08:35	Fillimi i pranimit të <i>file-ve</i>	<i>Batche-t</i> e urdhërpagesave me vlerë të vogël në pritje për miratim nga Banka mund të miratohen dhe të dërgohen në klering
10:00	Fundi i pranimit të <i>file-ve</i>	Pas këtij orari, Banka nuk mund të miratojë më <i>batch-e</i> me urdhërpagesa me vlerë të vogël për seancën e parë
10:05	Dërgimi i shlyerjes neto	Sistemi AECH dërgon instruksione të shlyerjeve neto në sistemin AIPS. Sistemi AIPS dërgon përgjigje tek sistemi AECH
10:15	Përfundimi i seancës së parë	Në sistemin MF Aech PS gjenerohen raporte elektronike për pagesat e shlyera në sistemin AIPS dhe për pagesat e anuluar në sistemin Aech. <i>Batch-et</i> e urdhërpagesave me vlerë të vogël shpërndahen tek pjesëmarrësit përfitues.

10:30	Fillimi i seancës së dytë të kleringut	Ministria mund të dërgojë <i>file-et</i> me urdhërpagesa
10:35	Fillimi i pranimi të <i>file-ve</i>	<i>Batch-et</i> e urdhërpagesave me vlerë të vogël në pritje për miratim nga Banka mund të miratohen dhe të dërgohen në klering
12:30	Fundi i pranimi të <i>file-ve</i>	Pas këtij orari, Banka nuk mund të miratojë më <i>batch-e</i> me urdhërpagesa me vlerë të vogël për seancën e dytë.
12:35	Dërgimi i shlyerjes neto	Sistemi AECH dërgon instruksionin e shlyerjes neto tek AIPS. AIPS dërgon përgjigje në sistemin AECH.
12:45	Përfundimi i seancës së dytë	Në sistemin MF Aech PS gjenerohen raporte elektronike për pagesat e shlyera në sistemin Aips dhe për pagesat e anuluar në sistemin Aech. <i>Batch-et</i> e urdhërpagesave me vlerë të vogël shpërndahen tek pjesëmarrësit përfitues.
13:00	Fillimi i seancës së tretë të kleringut	Ministria mund të dërgojë <i>file-et</i> me urdhërpagesa
13:35	Fillimi i pranimi të <i>file-ve</i>	<i>Batch-et</i> e urdhërpagesave me vlerë të vogël që presin për miratim nga Banka mund të miratohen dhe të dërgohen në klering.
14:45	Fundi i pranimi të <i>file-ve</i>	Pas këtij orari, Banka nuk mund të miratojë më <i>batch-e</i> me urdhërpagesa me vlerë të vogël për seancën e dytë
14:50	Dërgimi i shlyerjes neto	Sistemi AECH dërgon instruksionin e shlyerjes neto tek AIPS. AIPS dërgon përgjigje në sistemin AECH
15:00	Përfundimi i seancës së tretë	<i>Batch-et</i> e urdhërpagesave me vlerë të vogël në pritje për miratim nga Banka e Shqipërisë mund të miratohen dhe të dërgohen për klerim
16:00	<i>Cut-off</i>	Nuk pranohet asnjë informacion i mëtejshëm. Nxirret raporti që përmban debitimin direkt dhe që tregon për debitimet direkte që do të shlyhet në ditën tjetër të punës. <i>Batch-et</i> UPVV të cilët nuk janë dërguar ose miratuar përpara “ fundit të pranimi të <i>file-ve</i> ” për seancën e tretë refuzohen nga sistemi. Sistemi AECH dërgon raportet tek pjesëmarrësit përkatës ku përfshihen detaje lidhur me refuzimet e tyre.
16:15	Fundi i ditës, mbyllja e sistemit	Kryhen procedurat e mbylljes së ditës , gjenerohen raportet e fundit të ditës.

Ditët operuese sipas Rregullores Nr.103 datë 29/12/2001, neni Nr.27 “Për Kushtet e Përgjithshme të punës në Bankën e Shqipërisë”, është çdo ditë nga e hëna në të premten, përveç ditëve të festave zyrtare.

Sistemi AECH operon në përputhje me kalendarin zyrtar të vendit (shih www.bankofalbania.org).

11. Instrumentet e raportimit

11.1 Paraqitja e raporteve

Kjo pikë detajon instrumentet e vlefshëm raportues për një pjesëmarrës:

- Në fund të çdo seance
- Në çdo kohë gjatë ditës së punës
- Në fund të ditës

Në fund të çdo seance (fundi i seancës) dhe në fund të ditës, gjenerohen raporte gjithëpërfshirës lidhur me të gjithë veprimet e kryera në sistemin AECH. Gjithashtu, jepen grafikë dhe mund të shikohen në vazhdimësi të seancës. Grafikët e seancave përditësohen çdo disa sekonda të caktuara (sipas parametrit).

Raporte të ndryshme të fundit të ditës mund të shfaqen gjatë ditës si raporte brenda ditës. Megjithatë, këto raporte nuk përfshijnë informacionin shlyerës nga seanca e cila është në proces, sepse instruksionet e pagesave në atë seancë ende nuk janë shlyer. Këto raporte janë:

- *Position report*
- *End-of-day report*
- *Recap report*
- *Total file activity report;*
- *Audit report*

Të gjithë raportet kanë një datë dhe orë të nxjerrjes së tyre. Gjithashtu në të jepen, ora, data dhe seanca, ose periudha kohore, të cilës i referohet raporti, ashtu si monedha në të cilën raportohen shifrat.

Numrat e seancës jepen në AECH në formën viti-muaji-data-numri (yyyymmddnn), ku nn është numri i seancës, Nëse janë zhvilluar seanca të ndryshme në një ditë të veçantë, seancat e mbetura numërohen në vijimësi nga 1 pa hapësirë. Në raporte, numrat e seancës jepen si “ nr seancës n dd/mm/vvvv”.

11.2 Dërgimi i raporteve

Raportet kryesorë të seancës dërgohen automatikisht tek pjesëmarrësit me e-mail nga AECH në formatin PDF për të ofruar një regjistrim zyrtar të veprimtarisë së seancës.

Dërgimi i Raporteve tek Pjesëmarrësit mund të realizohet dhe nëpërmjet katër mënyrave të tjera, si më poshtë:

- Raportet e shfaqur në ekran mund të printohen;
- Kopje zyrtare të raporteve të rregullt në format PDF mund të shkarkohen ose të printohen;
- Raportet mund të shkarkohen si fletë *Excel* për qëllime analize;
- Raport me kërkesë të pjesëmarrësit, të cilat i drejtohen BSH-së dhe dërgohen me e-mail prej saj. Për raportet me kërkesë mund të ketë tarifë.

Për raportet dhe grafikët e vlefshëm, detaje të operacioneve në lidhje me secilën periudhë, ju mund t'i referoheni Manualit Teknik të sistemit AECH, Pika Nr.15.

Shënim: Banka e Shqipërisë mund të shohë raportet e të gjithë pjesëmarrësve, por pjesëmarrësit mund të shohin vetëm të dhënat e tyre.

12. Gjurmë të kontrollit / auditit

Sistemi AECH krijon automatikisht gjurmë kontrolli për të gjithë operacionet e veprimtarisë të hedhur në sistem, dhe përfshin informacion për:

- orën kur është marrë transaksioni;
- ID e personit (ose sistemit – për shëmbull informacione dhe raporte nga AIPS ose *file* të dërguar duke përdorur metodën *Straight Through Processing*) që hedh transaksionin;
- ID e personit (ose sistemit) që modifikon ose miraton transaksionin;
- orën dhe ndryshimin e statusit të çdo transaksioni të mbajtur në sistem.

Gjurmët e kontrollit janë të dukshme në ekran të cilat mund të përditësohen me të dhënat, dhe përdoren nga përdoruesi për të gjurmuar historinë e përditësimit, ndryshimin në pozicione neto ose rrugën e një *file-i* ose *batch-i* instruksionesh nëpërmjet sistemit.

Raporti i kontrollit (shihni më sipër) jep detaje të plota të hapave të procesimit të kaluar nga të gjithë *batch-et* e hedhur në sistemin AECH qendror.

Gjithashtu sistemi shfaq dhe *log-et* teknike të cilat tregojnë proceset e sistemit dhe të të gjithë përdoruesve.

KAPITULLI II

PJESËMARRJA NË SISTEMIN AECH

1. PJESËMARRJA

1.1 Kërkesa për Pjesëmarrje

Pjesëmarrës në sistemin AECH janë:

- Banka e Shqipërisë (BSH), në rolet e saj si pronare dhe operatore e sistemit;
- Bankat – subjekte ligjore shqiptare ose degë të bankave të huaja që veprojnë në Shqipëri, në përputhje me licencën e dhënë nga Banka e Shqipërisë (shih Ligjin Nr. 9662 datë 18/12/2006)
- Ministria e Financave.

Bankat që kërkojnë të anëtarësohen si pjesëmarrëse të drejtpërdrejta në sistemin e AECH duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- të jenë paraprakisht anëtare në sistemin AIPS;
- të kenë hartuar rregulla të brendshme të funksionimit të sistemit AECH, me këshillimin e BSH-së, Aneksit A.3;
- të kenë personel të kualifikuar dhe të trajnuar për operimin në sistemin AECH;
- të kenë nënshkruar kontratën tip të pjesëmarrjes në sistemin AECH me BSH-në, sipas Aneksit A.5;
- të marrin pjesë në Sistemin AECH vetëm nëpërmjet drejtorive qendrore të tyre;
- çdo kandidat për pjesëmarrje në sistemin AECH, paraprakisht duhet të jetë anëtar në AECH CUG të shërbimit të SWIFTNet FileAct (shih Rregulloren Nr.55, datë 26/09/2007, Neni Nr.18);
- të plotësojnë kushtet teknike të përcaktuara në Aneksin A.3.

Përfaqësim i autoritetit bankar në nivelin e firmave të autorizuara kryhet në përputhje me Nenin Nr. 4, të Vendimit Nr.17 datë 26/02/2003, "Kushte të veçanta pune në Bankën e Shqipërisë".

Kërkesa dhe/ose urdhrat të dërguara nga pjesëmarrësi me një njoftim zyrtar do të jenë ligjërish të pranueshëm. BSH do t'i ekzekutojë vetëm nëse përmbushin kushtet e përcaktuara në Vendimin Nr.17 datë 26/02/2003.

1.2 Kërkesa teknike

Me qëllim që të marrim pjesë në sistemin AECH, pjesëmarrësit do të përdorin një kod identifikimi që i jepet nga Banka e Shqipërisë dhe do të përmbushin kërkesat e tjera teknike të dhëna (shih kërkesat teknike, version në gjuhën angleze).

Çdo pjesëmarrës ka një BIC Code të vetëm (shih [www.bankofalbania.org/Sistemet e Pagesave](http://www.bankofalbania.org/Sistemet_e_Pagesave)).

1.3 Kategoritë e pjesëmarrjes

Pjesëmarrësit në sistemin AECH janë:

a) **Pjesëmarrës të drejtpërdrejtë**, të cilët dërgojnë dhe marrin *file* me pagesa në emër të tyre dhe që shlyejnë nëpërmjet llogarive të tyre të shlyerjes në sistemin AIPS (shih Rregulloren Nr. 53 datë 26/09/2007):

i) BSH, në rolin e saj si operatore e sistemit dhe pjesëmarrëse për të kryer veprimet dhe funksionet e saj;

ii) Bankat që u është dhënë një licencë nga BSH, si pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në këtë sistem, pas përmbushjes së kushteve (shih Kapitulli II, Pika. 1.1);

b) **Pjesëmarrës të tërthortë**, i cili dërgon dhe merr *file* me pagesa në emër të tyre, por që shlyejnë në sistemin AIPS nëpërmjet llogarisë të një pjesëmarrësi tjetër, i cili është agjenti i tyre shlyerës, ku përfshihen:

i) Ministria e Financave (Drejtoria e Thesarit) sipas marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet BSH dhe MF për komunikimin elektronik të veprimeve të thesarit nëpërmjet AIPS dhe AECH dhe procedurat operuese të ndërfaqes.

ii) subjekte të tjera, të miratuara me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

2. Përfundimi i procesit të pjesëmarrjes

2.1 Aplikimi për pjesëmarrje, formulari i pjesëmarrjes

Kandidati, për pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në sistem, dërgon kërkesën me shkrim pranë BSH-së për pjesëmarrjen e tij në sistemin AECH.

BSH-ja analizon kërkesën e kandidatit për pjesëmarrje në sistemin AECH.

Në rast miratimi të kërkesës, BSH-ja e njofton kandidatin brenda një jave, mbi përmbajtjen e rregulloreve të sistemit, tarifat e pjesëmarrjes në sistemin AECH dhe për kërkesat minimale teknike që duhet të përmbushë pjesëmarrësi.

BSH-ja në bashkëpunim me kandidatin, përcakton dhe zbaton kalendarin e anëtarësimit si specifikohet në Aneksin A.3.

Kandidati për pjesëmarrje plotëson dhe nënshkruan formularët e dhënë në Aneksin A.4.

BSH-ja njofton me shkresë zyrtare të gjithë pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë në sistemin AECH për emrin, adresën e saktë (Kodin BIC) të pjesëmarrësit të ri, si dhe për datën në të cilën këtij pjesëmarrësi do t'i jepet akses në sistemin AECH, 5 ditë pune para kësaj date.

2.2 Nënshkrimi i kontratës së pjesëmarrjes

Kandidati pjesëmarrës, nënshkruan me Bankën e Shqipërisë, kontratën tip për pjesëmarrje në sistemin AECH, sipas modelit të paraqitur në Aneks A.5.

KAPITULLI III

TARIFAT DHE GJOBAT

1. Tarifat

BANKA E SHQIPËRISË
Tarifat për përdorimin e sistemit AECH
(Miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës, Nr.12, datë 23.02.2011)

Komponenti	Përshkrim/detajim	Tarifa në lekë (bëhet)
Tarifë për pjesëmarrje në sistem	E pagueshme çdo muaj	0
Tarifë për transaksion	E pagueshme çdo muaj	
	Për urdhërpagesat:	
	Seanca e parë	4
	Seanca e dytë	6
	Seanca e tretë	8
	Për debitimin direkt	6
	Për refuzimin e debitimit direkt	6
Tarifa të veçanta	E pagueshme në fillim të muajit pasardhës	

Transaksionet e sistemit të dërguara në Bankën e Shqipërisë në rastet e pamundësisë së pjesëmarrësve për të dërguar ose marrë pagesat nga sistemi i tyre i pjesëmarrësit	Për vëllim ditor në intervalin 1-50 instruksione pagese	1,000
	Për vëllim ditor në intervalin 51-100 instruksione pagese	2,000
	Për vëllim ditor në intervalin 101-200 instruksione pagese	3,000
	Për vëllim ditor mbi 200 instruksione pagese	4,000
Blokimi i përkohshëm i llogarisë së pjesëmarrësit		50,000
Shërbime të tjera	E pagueshme pas çdo shërbimi	
	Dhënie e kartave për aksesimin e sistemit	Me koston e blerjes për njësi
	Dhënie pajisjesh për leximin e kartave të aksesimit në sistem	Me koston e blerjes për njësi

2. Gjobat

Për çdo ditë vonesë (për numër ditësh) në kthimin e fondeve, banka përfituese e begatuar pa shkak, sanksionohet nga banka urdhëruese, e cila pretendon begatimin pa shkak të bankës përfituese me **normën e repove 1-javore + 2 pikë përqindje**.

Në rast se banka përfituese/debitore, subjekt i begatimit pa shkak, nuk shlyen detyrimet e saj për shumën dhe në afatet e përcaktuara, kjo përbën shkelje të rregullave sic përcaktohet në Rregulloren Nr. 55 datë 26/09/2007.

KAPITULLI IV

PROCEDURAT NË SITUATA JONORMALE

1. Përcaktimi i ngjarjeve të paparashikuara

Ngjarje të paparashikuara – nënkupton ngjarjet, të cilat sjellin probleme gjatë shkëmbimit normal dhe në kohë të *file-eve*, në procesin e klerimit dhe në shlyerjet neto (NSI) nëpërmjet sistemit AIPS.

Ngjarjet e paparashikuara klasifikohen si më poshtë:

- a) ngjarjet e paparashikuara të një pjesëmarrësi të veçantë;
- b) ngjarjet e paparashikuara në komunikimin SWIFT pranë BSH-së;
- c) ngjarjet e paparashikuara në ndërfaqet AIPS – AECH;
- d) ngjarjet e paparashikuara të sistemit AECH qendror;
- e) ngjarjet e paparashikuara në komunikimin me rrjetin VPN;
- f) ngjarjet e paparashikuara në rrjetin elektrik, të cilat shkaktojnë një ose disa nga ngjarjet e mësipërme.

2. Procedurat për administrimin e ngjarjeve të paparashikuara

Administrimi i ngjarjeve të paparashikuara është përgjegjësi kolektive e pjesëmarrësve me mbështetjen e *help desk-ut* të BSH-së. Procedurat për administrimin e ngjarjeve të paparashikuara fillojnë me zbulimin e problemit.

Në qoftëse se ngjarja është sipas pikës 1.a, procedurat janë si vijon :

- BSH-ja njofton pjesëmarrësit e tjerë, në rastet kur ajo e gjykon se problemi i një pjesëmarrësi mund të shkaktojë zvarritje apo probleme të tjera në funksionimin e përgjithshëm të sistemit AECH.
- Secili nga pjesëmarrësit e tjerë duhet të ndërmarrë një vendim individual për të vazhduar ose jo dërgimin e mesazheve të pagesës në favor të pjesëmarrësit që ka njoftuar për probleme.
- Nëse një pjesëmarrës ndeshet me vështirësi që bëjnë të pamundur dërgimin e file-ve, por lejojnë hyrjen e pagesave, problemi ka ndodhur në sistemin e tij *back-office* dhe jo të AECH pjesëmarrës. Ky pjesëmarrës duhet të sigurojë vazhdimësinë e hyrjes së *file-eve* të pagesave në sistemin e tij.
- Në rast të mosfunksionimit të rrjetit VNP, pjesëmarrësi i kërkon BSH-së me shkresë zyrtare, MT999 ose e-mail, të aprovojë *batch-et* e tij.
- Në rast të mosfunksionimit të lidhjes me SWIFTNet FileAct, pjesëmarrësi duhet të vazhdojë dërgimin e *batche-ve* të tij dhe marrjen e *batche-ve* të pagesave të shlyera në favor të tij me mbajtës elektronikë të shoqëruar me shkresë zyrtare të nënshkruar nga personat përkatës të autorizuar.
- Në rast të mosfunksionimit të sistemit të pjesëmarrësit AECH primar dhe *backup*, Banka e Shqipërisë ndihmon pjesëmarrësin të krijojë një sistem AECH pjesëmarrës të ri.

Në rast se ngjarja e paparashikuar është sipas pikës 1.b, procedurat janë si vijon :

- Në rast të një mosfunksionimi të zgjatur të sistemit SWIFT pranë BSH-së, kjo e fundit njofton pjesëmarrësit nëpërmjet kontakteve të emergjencës, me e-mail të sigurt të sistemit AECH, e-mail të zakonshëm, faks dhe në mungesë të mënyrave të sipërpërmendura, me telefon.
- Në rast të ndërprerjes të lidhjes me SWIFT, pjesëmarrësit duhet të mbeten të lidhur në *webstation-at* e tyre të sistemit AECH qendror, për të monitoruar situatën.
- BSH-ja zhvendoset në sistemin *backup* të SWIFT-it dhe njofton për këtë pjesëmarrësit nëpërmjet kontakteve të emergjencës.
- Nëse edhe zhvendosja në sistemin *backup* të SWIFT-it nuk është e mundur, atëherë BSH-ja instruktore pjesëmarrësit me faks ose me e-mail, që të zbatojnë procedurat e *fallback-un* me anë të shkëmbimit të *file-ve* të AECH me mbajtës elektronikë.
- Ngjarja e paparashikuar *fallback* duhet t'u njoftohet pjesëmarrësve në sistem nëpërmjet kontakteve të emergjencës, me e-mail të sigurt të sistemit AECH, e-mail të zakonshëm, faks ose telefon.

Në rast se ngjarja e paparashikuar është sipas pikës 1.c, procedurat janë si vijon :

- Në rastet kur instruksioni i shlyerjes neto (NSI) nuk kalon nga sistemi AECH në AIPS, atëherë në sistemin AIPS do të importohet instruksioni i shlyerjes neto.
- Në rast se nuk realizohet edhe importi i instruksionit të shlyerjes neto, atëherë në sistemin AIPS do të hidhen manualisht rezultatet neto të shlyerjes.
- Në rast se konfirmimi i shlyerjes në sistemin AIPS nuk kalon nga AIPS në AECH qendror, atëherë NSI (*Instruksioni i Shlyerje Neto*) në AIPS ekzekutohet manualisht në sistemin AECH qendror.

Në rast se ngjarja e paparashikuar është sipas pikës 1.d, procedurat janë si vijon :

Në qoftë se problemi ka ndodhur në vendndodhjen e sistemit AECH Qendror, atëherë *help desk* njofton Administratorin e Sigurisë së AECH tek çdo pjesëmarrësi dhe jep të gjitha udhëzimet e nevojshme. Në më të shumtën e rasteve, falë rregullimeve në *fallback*, një dështim në site-in e AECH do të sjellë vetëm një ndërprerje të shkurtër të shërbimit.

- Një ngjarje e paparashikuar e sistemit AECH qendror ndodh kur ky i fundit nuk mund të përpunojë *batch*-e dhe/ose të përgatisë instruksionin e shlyerjes neto për ta kaluar në AIPS, në *site-in* primar ose *backup*.
- Në rast të një defekti të zgjatur në sistemin AECH qendror, BSH-ja do të konsultohet dhe do të komunikojë me pjesëmarrësit duke përdorur kontaktet e emergjencës sipas Aneksit A.4.
- Në rast të mosfunksionimit të sistemit AECH qendror primar do të vihet në punë sistemi AECH qendror *backup*.
- Në rast të mosfunksionimit të asnjërit prej tyre, veprimet do të kryhen në sistemin AIPS.

Në rast se ngjarja e paparashikuar është sipas pikës 1.e, procedurat janë si vijon :

- Në rast defekti në linjat e internetit që përdoren për VPN, vihen në funksionim linjat *backup* të bazuara në *dial-up*.
- Në rast të mosfunksionimit edhe të linjës *dial-up*, (pjesëmarrësit nuk kanë akses në sistem nëpërmjet rrjetit VPN), atëherë BSH-ja me kërkesën e pjesëmarrësit kryen operacionet e miratimit të *batch*-eve për llogari të pjesëmarrësit. Raportet mund të shpërndahen me mjete alternative (të printuara ose elektronike).

3. Komunikimi i ngjarjeve të paparashikuara

Në qoftë se pjesëmarrësi ndeshet me vështirësi teknike, të cilat e pengojnë të dërgojë ose të marrë pagesa dhe mesazhe të tjera në sistemin AECH, ai njofton BSH-në brenda 30 minutave nga konstatimi i këtij problemi. Pjesëmarrësit komunikojnë me BSH-në gjatë ngjarjeve të paparashikuara.

4. Zbulimi dhe raportimi i ngjarjeve të paparashikuara

Kurdoherë që haset një ngjarje, është përgjegjësi e operatorit të sistemit (BSH) të verifikojë sa më shpejt që të jetë e mundur, nëse ngjarja ka ndonjë ndikim teknik ndaj sistemit, ose drejtpërsëdrejti tek përdoruesit.

Në qoftë se gjatë këtij procesi verifikimi bëhet e qartë se ngjarja ndikon në sistem dhe tek përdoruesit e tij, ajo ngjarje do të trajtohet menjëherë. BSH-ja njofton pjesëmarrësit nëpërmjet kontakteve të emergjencës, nëpërmjet e-mail të zakonshëm, nëpërmjet e-mail të sigurt të AECH dhe, në rast të mospasjes së mjeteve të mësipërm të komunikimi, nëpërmjet telefonit.

Informacioni i shpërndarë, duhet të përmbajë, sa më shpejtë që të jetë e mundur, një përshkrim të saktë të ngjarjes, masat e mundshme administruese të marra, orën kur ka ndodhur dhe kohëzgjatjen e pritshme të ngjarjes (në qoftë se dihet).

5. Raportimi i ngjarjeve të paparashikuara

Është me rëndësi thelbësorë që një raport i një ngjarjeje të paparashikuar të japë një përshkrim gjithëpërfshirës të ngjarjes dhe të masave të ndërmarra në vijim të ngjarjes.

Ky raport duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme: datën, natyrën, masat e marra dhe shkallën e suksesit për të zgjidhur problemin.

Çdo pjesëmarrës regjistron të gjitha ngjarjet e paparashikuara dhe problemet e vërejtura në sistem dhe i raporton ato pranë BSH-së brenda 2 (dy) ditëve pune nga fundi i çdo muaji kalendarik. Format i këtij raportimi gjendet në [Aneksin A.6](#).

Pezullimi i sistemit AECH

Banka e Shqipërisë mund të pezullojë pjesërisht apo tërësisht funksionimin e sistemit, në rrethanat kur vazhdimi i funksionimit të tij do të kishte ndikim negativ mbi stabilitetin e sistemit, duke njoftuar menjëherë pjesëmarrësit për këtë.

Gjatë periudhës së pezullimit të funksionimit të sistemit, operacionet zhvillohen sipas mënyrës së përcaktuar rast pas rasti nga BSH-ja.

BSH-ja rivendos funksionimin e sistemit AECH sa më shpejt që të jetë e mundur, duke njoftuar menjëherë të gjithë pjesëmarrësit.

Aneks A.1 Parametrat e sistemit

Ndarjet kohore aktuale të parametrave të sistemit AECH janë si më poshtë:

Parametri	Ngjarja
Periudha maksimale e paraqitjes së debitimit direkt	10 ditë pune para datëvalutës
Periudha minimale e paraqitjes së debitimit direkt	3 ditë pune para datëvalutës
Fundi i periudhës pritëse të debitimit direkt	Nata e <i>Cut-off</i> para datëvalutës
Vlera maksimale e urdhërpagesës me vlerë të vogël	Më e vogël se 1.500.000
Vlera maksimale e debitimit direkt	Më e vogël se 1.500.000

Aneks A.2 Formular të mesazheve SWIFT

MT 103 Single Customer Credit Transfer

Tag	Field Name	Option letter	Support/Comments
20	File Seeence		Yes
13C	Time Indication	13C	No
23B	Bank Operation Code	23B	Yes
23E	Instruction Code	23E	No
26T	Transaction Type Code	26T	No
32A	Value Date, Currency Code, Amount	32A	Yes
33B	Currency/Instructed Amount	33B	No
36	Exchange Rate		No
50	Ordering Customer	50K	Yes. Format is [!a][/34x] – Account identifier 35x – Name 2*35x – Address

			35x – Fiscal Code
51A	Sending Institution	51A	No
52a	Ordering Institution	52A or 52D	Yes.
53a	Sender's Correspondent		No
54a	Receiver's Correspondent		No
55a	Third Reimbursement Institution		No
56a	Intermediary Institution		No
57a	Account With Institution	57A, 57B, 57C or 57D	Yes
59	Beneficiary Customer	No letter option	Yes. Format is [!a][/34x] – Account identifier 35x – Name 2*35x – Address 35x – Fiscal Code
70	Remittance Information		Yes
71A	Details of Charge	71A	Yes
71F	Sender's Charges	71F	No
71G	Receiver's Charges	71G	No
72	Sender to receiver information	72	Yes
77B	Regulatory Reporting	77B	No
77T	Envelope Contents	77T	No

MT 104 Direct Debit and Request for Debit Transfer Message

Shënim: Për mesazhet MT104 të Debitimit Direkt, i cili identifikohet si mesazh shumëpalësh sipas standardeve SWIFT, mesazhi pranohet vetëm për një pjesë

Tag	Field Name	Option letter	Support/Comments
Mandatory Sequence A General Information			
20	File Sequence		Yes
21R	Customer specific Sequence		No
23E	Instruction Code		No
21E	Registration Sequence		No
30	Requested Execution Date		Yes
51A	Sending Institution	51A	No
50a	Instructing Party		No

50	Creditor	50K	Yes. Format is [/1!a]/[34x] – Account identifier 35x – Name 2*35x – Address 35x – Fiscal Code
52a	Creditor's Bank	52A, 52C or 52D	Yes. Usage is conditioned by the presence of field 52a in each part of the message. If a value is set in one message part, it will be used for the respective part, and if it is not set, this will be used.
26T	Transaction Type Code	26T	No
77B	Regulatory Reporting	77B	No
71A	Details of Charge	71A	No
72	Sender to Receiver Information		Yes
Mandatory Repetitive Sequence B Transaction Details			
21	Transaction Seeence		Yes
23E	Instruction Code		No
21C	Mandate Seeence		No
21D	Direct Debit Seeence		No
21E	Registration Seeence		No
32B	Currency and Transaction Amount	32B	Yes
50a	Instructing Party	50a	No
50	Creditor	50K	Yes. Format is [/1!a]/[34x] – Account identifier 35x – Name 2*35x – Address 35x – Fiscal Code
52a	Creditor's Bank	52A, 52C or 52D	Yes. If present, this value will be used instead of the one present in the General Information header (if any).
57a	Debtor's Bank	57A, 57C or 57D	Yes
59	Debtor	No Letter Option	Yes. Format is [/1!a]/[34x] – Account identifier 35x – Name 2*35x – Address

			35x – Fiscal Code
70	Remittance Information		Yes
26T	Transaction Type Code	26T	No
77B	Regulatory Reporting	77B	No
33B	Currency and Original Ordered Amount	33B	No
71A	Details of Charge	71A	Yes
71F	Sender's Charges/Amount	71F	No
71G	Receiver's Charges/Amount	71G	No
36	Exchange Rate		No
Optional Sequence C Settlement Details			
32B	Currency Code, Amount	32B	Yes
19	Sum of Amounts		No
71F	Sum of Sender's Charges	71F	No
71G	Sum of Receiver's Charges	71G	No
53a	Sender's Correspondent		No

Aneks A.3 Fazat e Anëtarësimit

- I. Blerja e *hardware*, *software* dhe instalimi.
- II. Testimi dhe trajnimi.
- III. Përgatitja e dokumentacionit.
- IV. Implementimi dhe kalimi në LIVE.

FAZA E PARË: Blerja e *hardware* dhe *software*, instalimi

1. Kandidati për pjesëmarrës në AECH do të sigurojë:
 - a. Serverin e AECH pjesëmarrës si në "Server technical specifications for PS in AECH Participant Technical Requirements v1.0.doc";
 - b. S.W.I.F.T Starter Set ose ndërfaqe të tjera të komunikimit me rrjetin SWIFTnet (Tipi i ndërfaqes do përcaktohet në bisedime me kompaninë SWIFT);

- c. Kompjuter personal (PC) që do të shërbejë si *webstation* i sistemit AECH qendror. Ky kompjuter mund të jetë i njëjtë me *webstation* monitorues të AIPS ose tjetër;
 - d. ndërfaqet e serverit PS me aplikimet e tij të brendshme.
2. Banka e Shqipërisë do të sigurojë:
- a. lexuesit e kartave (*Cards Readers*), kundrejt një pagese
 - b. kartat e sigurisë (*Smart Cards*), kundrejt pagesës;
 - c. PS Software, falas;
 - d. VPN Software, falas;
 - e. dokumentet e nevojshëm (falas).

FAZA E DYTË: Testimi dhe trajnimi

1. Anëtarësimi në shërbimin *test boa.aech!p* të SWIFNET Fileact për AECH.
 - a. kandidati për pjesëmarrës duhet të plotësojë *online* formularin në internet përkatës në *www.SWIFT.com*;
 - b. Banka e Shqipërisë miraton *online* formularin e kandidatit;
 - c. kompania SWIFT shton kandidatin në AECH CUG të *boa.aech!p*.
2. Testimi i shkëmbimit të skedarëve në *boa.aech!p* ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe bankës kandidate.
3. Banka e Shqipërisë do të trajnojë 2 ose 3 punonjës të kandidatit në sistemin AECH qendror dhe AECH pjesëmarrës.
4. Kandidati do të përgatisë formularët VPN për ambientet e testimit, sipas Shtojcës H të Rregullores Nr 55, datë 26/09//2007.
5. Banka e Shqipërisë do të përgatisë përdoruesit në AECH qendror TEST, VPN, dhe çertifikatat përkatëse.
6. Banka e Shqipërisë do të instalojë, në ambientet e pjesëmarrësit *software* e AECH pjesëmarrës dhe VPN.
7. Kandidati në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë do të ekzekutojnë skenarin e testimit dhe do ta firmosë atë.

FAZA E TRETË: Përgatitja e dokumenteve

1. Kandidati do të përgatisë "Rregullat dhe procedurat e brendshme të AECH" të tij në përputhje me këtë rregullore.
2. Dokumentacioni i përfunduar do të dorëzohet pranë Bankës së Shqipërisë për miratim.
3. Banka e Shqipërisë bën vërejtjet/modifikimet e saj nëse bien ndesh me këtë rregullore dhe të tjera të Bankës së Shqipërisë dhe ia pasqyron bankës kandidate.

4. Banka kandidate sjell në versionin përfundimtar “Rregullat dhe procedurat e brendshme të funksionimit të AECH” të përpunuara, ku ka marrë parasysh tërë korrigjimet e Bankës së Shqipërisë.

FAZA E KATËRT: Përgatitja për mjedisin *LIVE*

1. Banka e Shqipërisë përgatit dhe i dorëzon pjesëmarrësit certifikatën e anëtarësimit.
2. Kandidati dhe Banka e Shqipërisë nënshkruajnë kontratën tip për pjesëmarrje në AECH.
3. Anëtarësimi në shërbimin *LIVE* **boa.aech** të SWIFTNET Fileact për AECH:
 - a. Pjesëmarrësi duhet të plotësojë *online* në internet formularin përkatës në *www.SWIFT.com*.
 - b. Banka e Shqipërisë miraton *online* formularin e pjesëmarrësit;
 - c. Kompania SWIFT shton pjesëmarrësin në AECH CUG të *boa.aech*.
4. Testimi i shkëmbimit të skedarëve në **boa.aech** SWIFTNet FileACT ndërmjet pjesëmarrësit dhe Bankës së Shqipërisë.
5. Pjesëmarrësi do të plotësojë dhe do të dorëzojë pranë Bankës së Shqipërisë formularët:
 - a. Sipas përcaktimeve (referoju Rregullores nr. 55 datë 26/09/2007, Shtojca D) për pjesëmarrjen në AECH qendror;
 - b. Sipas përcaktimeve (referoju Rregullores nr.55 datë 26/09/2007, Shtojca G) për pajisjet e sigurisë dhe përdoruesit në AECH qendror dhe AECH pjesëmarrës;
 - c. Sipas përcaktimeve (referoju Rregullores nr.55 datë 26/09/2007, Shtojca H) për përdoruesit në VPN.
6. Pjesëmarrësi do të përgatisë përdoruesit në AECH pjesëmarrës.
7. Pas aprovimit nga Banka e Shqipërisë krijohet profili i pjesëmarrësit në AECH qendror, përgatiten kartat e sigurisë me certifikatat e përdoruesve, krijohen përdoruesit në ambientin AECH qendror *LIVE*, krijohen përdoruesit në VNP dhe pjesëmarrësit i dorëzohen pajisjet e sigurisë.
8. Banka e Shqipërisë përcakton ditën e kalimi *LIVE* të pjesëmarrësit dhe njofton me email të gjithë pjesëmarrësit e sistemit AECH.
9. Kalimi *LIVE*.

Aneksi A.4 Formular për pjesëmarrje në AECH

Pjesëmarrësi:

Kodi BIC:

Adresa:

Kontaktet për zgjidhjen e problemeve

Person kontakti për pagesat:		
Emër, Mbiemër		
Detyra që mbulon		
Telefon		
celular		
E-mail		
Person Kontakti për TI		
Emër, Mbiemër		
Detyra që mbulon		
Telefon		
Celular		
E-mail		

DATE _____

Nënshkrimi _____

Kontrata e pjesëmarrjes në AECH (Albanian Electronic Clearing House)

Neni 1 – Palët

Kjo marrëveshje lidhet midis Bankës së Shqipërisë, me adresë: Sheshi “Skënderbej”, Nr. 1, Tiranë, përfaqësuar ligjërisht në këtë marrëveshje nga Zëvendësguvernatori i Parë, zj. _____ dhe bankës _____ (referuar më poshtë si “Pjesëmarrësi i drejtpërdrejtë”) me adresë _____, përfaqësuar nga drejtori i saj z. _____.

Neni 2 – Objekti

Objekti i kësaj kontrate është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të Bankës së Shqipërisë të cilat lindin në kuadrin e ofrimit prej saj të shërbimeve të klerimit së pagesave me vlerë të vogël në sistemin AECH si operatore dhe administratore e vetme e këtij sistemi si dhe e të drejtave dhe detyrimeve të bankës si pjesëmarrëse e drejtpërdrejtë në këtë sistem.

Neni 3 –Baza ligjore

Kjo kontratë hartohet në përputhje me:

- a) ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994” ”Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- b) ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- c) ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”;
- ç) rregulloren nr.55 datë 26.09.2007 “Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH)” (Rregullat e Sistemit AECH), të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë; si dhe
- d) akteve të tjera normative të Bankës së Shqipërisë.

Neni 4 – Përkufizime

4.1. Termat e përdorur në kontratë janë në përputhje me termat e përcaktuar në Rregullat e Sistemit AECH, të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

4.2. Çdo kusht ose formulim i kontratës që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Rregullave të Sistemit AECH dhe në këndvështrimin e qëllimit për të cilin është lidhur kjo kontratë nga palët.

4.3. Për të gjitha çështjet që nuk përcaktohen shprehimisht në këtë kontratë, aplikohen dispozitat ligjore në fuqi dhe Rregullat e Sistemit AECH.

Neni 5 – Kohëzgjatja

Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe do të zgjasë për një periudhë kohe të pacaktuar.

Neni 6 –Angazhimi i palëve

Pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë në sistemin AECH dhe Banka e Shqipërisë, angazhohen për zbatimin e kushteve të kësaj kontrate në lidhje me ofrimin e shërbimeve në kuadrin e sistemit AECH nga Banka e Shqipërisë, me qëllim shkëmbimin e file-ve të instruksioneve të urdhërpagesave me vlerë të vogël midis pjesëmarrësve; llogaritjen e pozicioneve shumëpalëshe neto; dërgimin e një instruksioni shlyerjeje neto në sistemin AIPS, si dhe për respektimin e ndryshimeve të herëpashershme që mund t'i bëhen kontratës, me pëlqimin paraprak të palëve.

Neni 7 – Pakthyeshmëria (parevokshmëria) e instruksioneve të pagesave në sistemin AECH

7.1. *Batch*-i i urdhërpagesave, i miratuar gjatë një seance nga një pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në sistemin AECH qendror, nuk mund të kthehet (revokohet).

7.2 Kthimi (revokimi) i debitimit direkt dërgohet në sistemin AECH qendror nga pjesëmarrësi debitor përpara mbarimit të cut-off-it të ditës së fundit para datëvalutës së klerimit të instruksioneve të debitimit direkt.

7.3. Pjesëmarrësi debitor duhet të kthejë (revokojë) të gjitha batch-et me debitime direkte, të dërguara nga një/disa pjesëmarrës kreditorë, në rastet kur pjesëmarrësi debitor nuk disponon fonde të mjaftueshme në llogarinë e tij të shlyerjes në sistemin AIPS.

7.4. Pjesëmarrësi kreditor mund të kërkojë kthimin e instruksionit të debitimit direkt vetëm nëpërmjet refuzimit të së njëjtës pagesë nga pjesëmarrësi debitor, minus tarifën përkatëse për përdorimin e sistemit AECH, sipas rregullave të këtij sistemi.

7.5. Pjesëmarrësi urdhërues mund të kërkojë kompensimin e një pagese të shlyer vetëm nëpërmjet inicimit të një pagese të re nga përfituesi i begatuar pa shkak, me kah të kundërt me urdhër pagesën fillestare minus komisionin e bankës së begatuar pa shkak dhe tarifës për përdorimin e sistemit, sipas përcaktimeve të Rregullave të sistemit AECH. Përfituesi nuk ka detyrim të kthejë menjëherë fondet e marra, subjekt i dispozitave të “Begatimit pa shkak”, por duhet t’i kthejë këto fonde në përputhje me Rregullat e Sistemit AECH.

Neni 8 – Efekti i likuidimit të pjesëmarrësit në pagesat e shlyera

8.1. Procedurat e likuidimit të pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë dhe/ose të pjesëmarrësve të sistemit AECH nuk kanë fuqi prapavepruese ndaj instruksioneve të pagesave të shlyera sipas instruksioneve të pagesave përkatëse, përpara datës në të cilën është marrë vendimi për likuidimin dhe emërimin e likuidatorit të pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë dhe/ose të një ose disa prej pjesëmarrësve të sistemit AECH.

8.2 Një instruksion pagese konsiderohet që ka hyrë në sistemin AECH qendror kur të ketë kaluar validimin për pranim nga ky i fundit dhe të jetë aprovuar nga pjesëmarrësi urdhërues/debitor (me përjashtim të rastit kur është përdorur mënyra STP).

8.3. Pika 1 e këtij neni zbatohet edhe për instruksionet e pagesave të hyra në sistemin AECH qendror, pas shpalljes së vendimit për likuidimin dhe emërimin e likuidatorit e më tej, vetëm nëse, pas shlyerjes, agjenti shlyerës dhe/ose agjenti/shtëpia e klerimit provon se nuk ka pasur dijeni për këtë vendim.

8.4 Banka e Shqipërisë ka të drejtë të përdorë si kolateral letrat me vlerë të pjesëmarrësit të vendosur në likuidim, me qëllim për të përmbushur detyrimet e tij ndaj pjesëmarrësve të tjerë të sistemit, vetëm në rast se këto letra me vlerë nuk janë përdorur si mjet për garantimin e ekzekutimit të detyrimeve të tjera.

Neni 9 – Të drejtat dhe detyrimet e Bankës së Shqipërisë

Banka e Shqipërisë, në rolin e saj si pronare, organizuese, administruese, operatore, mbikëqyrëse, agjente shlyerje dhe pjesëmarrëse në shlyerje, ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në Rregullat e Sistemit AECH.

Neni 10 – Të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësit

Pjesëmarrësi i drejtpërdrejtë në sistemin AECH, ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në Rregullat e Sistemit AECH.

Neni 11 – Mënyrat e informimit

11.1. Çdo njoftim, kërkesë ose çdo lloj komunikimi ndërmjet palëve bëhet me postë zyrtare të regjistruar, faks, e-mail dhe në rastet kur komunikimi me mjetet e lartpërmendura është i pamundur, me telefon në adresat, numrat telefonikë dhe personat e kontaktit përkatës të palëve.

11.2. Secila palë është e detyruar të njoftojë palën tjetër për ndryshimet e mundshme të adresave, numrave telefonikë dhe të personave të kontaktit brenda 5 ditësh pune nga ndryshimi i tyre.

11.3. Në rast se njoftimi ose kërkesa mbërrin tek i adresuari pas orës 16.00 të ditës së punës, përjashtimisht nga paragrafët e mësipërm, ai cilësohet i marrë në orën 08.05 të ditës pasardhëse të punës.

Neni 12 – Ndryshime të kontratës

12.1. Kushtet e kësaj kontrate mund të ndryshohen vetëm me shkrim dhe me vullnetin, dhe pëlqimin e të dyja palëve.

12.2. Çdo ndryshim, shtesë ose shfuqizim i plotë ose i pjesshëm i kësaj kontrate nuk do të ketë fuqi nëse nuk është kryer me shkrim dhe nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar të të dyja palëve.

Neni 13 – Zgjidhja e kontratës

13.1 Palët kanë të drejtë të zgjidhin kontratën në mënyrë të njëanshme duke njoftuar me shkrim palën tjetër, të paktën 10 (dhjetë) ditë përpara datës që ata dëshirojnë të zgjidhin kontratën duke kërkuar plotësimin e detyrimeve financiare të cilat rrjedhin nga kjo kontratë.

13.2 Kontrata mund të zgjidhet sipas pikës 1 të këtij neni edhe pas miratimit nga Banka e Shqipërisë të kërkesës me shkrim së pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë për t'u tërhequr nga pjesëmarrja në sistemin AECH të paraqitur në afatin e përcaktuar në pikën 13.1. Kontrata konsiderohet e zgjidhur në datën të përcaktuar paraprakisht në kërkesë, datë në të cilën ai synon të tërhiqet nga pjesëmarrja në sistemin AECH.

13.3 Pas marrjes së kërkesës në përputhje me pikën 13.2., Banka e Shqipërisë brenda 7 ditësh refuzon ose miraton kërkesën si dhe informon të gjithë pjesëmarrësit e sistemit AECH mbi datën e tërheqjes së pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë. Në rast se Banka e Shqipërisë miraton kërkesën, pjesëmarrësi i

drejtpërdrejtë nuk lejohet të iniciojë instruksione të reja pagese me datë valutë pas datës së përcaktuar në vendimin për tërheqjen e tij..

13.4 Në datën e tërheqjes nga pjesëmarrja në AECH, Banka e Shqipërisë mbyll dhe fshin llogarinë e teknike të pjesëmarrësit në AECH pas mbledhjes së tarifave dhe pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve të pjesëmarrësit të tërhequr në lidhje me instruksionet e vlefshme të pagesave, tashmë të pranuar.

Neni 14 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

14.1. Palët respektojnë legjislacionin shqiptar në fuqi dhe përpiqen që mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kontratës, t'i zgjidhin me mirëkuptim midis tyre.

14.2. Pala që gjykon se ekziston një mosmarrëveshje, njofton palën tjetër duke bërë një përshkrim të plotë të çështjeve që kërkojnë zgjidhje.

14.3. Personat e autorizuar të palëve të përfshira në mosmarrëveshje duhet të bëjnë personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesve të tyre përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, mbi parimin e ruajtjes së vazhdimësisë së punës.

14.4. Nëse personat e autorizuar të palëve apo përfaqësuesit e tyre nuk janë në gjendje të zgjidhin mosmarrëveshjen brenda 14 ditësh nga marrja e njoftimit apo për një kohë më të gjatë të miratuar nga palët, njëra palë njofton palën tjetër se çështja nuk është zgjidhur.

14.5. Për të gjitha mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent është Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë

Neni 15 – Hyrja në fuqi

15.1. Kjo kontratë është përpiluar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe secila nga palët mban një kopje.

15.2. Kontrata pasi u lexua nga palët, u konsiderua e redaktuar sipas pëlqimit të tyre dhe u nënshkrua me vullnetin e tyre të lirë e të pavarur.

15.3. Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Kontaktet fillestare

Detajet kontaktuese të palëve janë si më poshtë:

Banka e Shqipërisë

Për vëmendjen e:.....

Banka e Shqipërisë

Sheshi "Skënderbej", Nr. 1, Tiranë, Shqipëri

Tel: 04 2

Fax: 04 2

Pjesëmarrësi:

Për vëmendjen e:

.....

.....

.....

Tel:

Fax:

Kjo kontratë firmoset nga:

Për BANKËN E SHQIPËRISË

.....

Emri dhe firma e personit të autorizuar

Në praninë e:

.....

Emri dhe firma e dëshmitarit

për PJESËMARRËSIN

.....

Emri dhe firma e personit të autorizuar

Në praninë e:

.....

Emri dhe firma e dëshmitarit

Kontrata tip

“Për një ndryshim në Kontratën e pjesëmarrjes në AECH (Albanian Electronic Clearing House)

Neni 1

Kjo kontratë lidhet midis Bankës së Shqipërisë. Me adresë: Rruga e “Dibrës”, Kompleksi Halili, Kulla B, Tiranë”, përfaqësuar ligjërisht nga Zëvendës Guvernatori i Parë, zj. _____ dhe Bankës _____ (referuar më poshtë si “Pjesëmarrësi i drejtpërdrejtë”0 me adresë _____, përfaqësuar nga drejtori i saj z. _____.

Neni 2

Në nenin 10, pas paragrafit 1, shtohet paragrafi 2 sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“Komisionet për urdhërpagesat në lekë, që klientët i paguajnë bankave, nuk duhet të jenë më të mëdha se 500 për të gjitha pagesat në nisje në AECH, kurse urdhërpagesat në mbërritje janë pa komision”.

Neni 3

Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Për Bankën e Shqipërisë

.....
Emri dhe firma e personit të autorizuar
Në praninë e:

.....
Emri dhe firma e dëshmitarit

Për Pjesëmarrësin

.....
Emri dhe firma e personit të autorizuar:
Në praninë e:

.....
Emri dhe firma e dëshmitarit

Aneks A.6 Regjistrimi i ngjarjeve të paparashikuara

Banka _____ për muajin _____ të vitit _____

Data e ngjarjes	Ora e ngjarjes	Natyra e problemit	Veprimi i ndërmarrë	Ora e rregullimit të problemit

Dërgojeni këtë raport në fund të muaji tek njësia që mbulon suportin e sistemit AECH

SEKSIONI B

MANUALI PËR KLERIMIN E ÇEQEVE NË MONEDHË KOMBËTARË (LEK)

1. Baza ligjore për klerimin e çeqeve

- a) Dekreti i datës 08/07/1963 "Për çeqet", ndryshuar me Ligjin Nr.7782 datë 26/01/1994, "Për disa ndryshime dhe shtesa në dekretin Nr.3702 datë 08/07/1963 " Për çeqet ";
- b) Rregullorja Nr.148 datë 20/11/1998 "Për sistemet dhe instrumentet e pagesave";
- c) Rregullorja Nr.83 datë 15/11/2006 "Për organizimin e klerimit të çeqeve në lek në Bankën e Shqipërisë ".

2. Organizimi i klerimit të çeqeve në lek

2.1 Seanca e klerimit të çeqeve

Seanca e klerimit zhvillohet çdo ditë pune në orën 13:00, në ambientet e Bankës së Shqipërisë, në Tiranë.

Gjatë seancës së kleringut të çeqeve, Pjesëmarrësit shkëmbejnë informacione për çeqet në lek. Rezultati i seancës së kleringut të çeqeve llogaritet në bazë neto shumëpalëshe dhe paraqitet në formularin e instruksionit të shlyerjes neto (shih Aneksi B. 4).

Drejtimi i seancës së kleringut kryhet nga një prej specialistëve të Sektorit të Pagesave, pranë Departamentit të Sistemeve të Pagesave, në Bankën e Shqipërisë.

2.2 Pjesëmarrja në seancën e kleringut

Çdo bankë përfaqësohet në seancën e kleringut nëpërmjet përfaqësuesve të saj të autorizuar për këtë qëllim. Përfaqësuesit e autorizuar caktohen nga çdo bankë në përputhje me kërkesën për anëtarësim në seancën e kleringut (shih Aneksin B.1).

Banka prezantohet në seancën e kleringut edhe në rast se nuk ka asnjë çek për të dërguar tek pjesëmarrësit, me qëllim marrjen e dokumenteve nga pjesëmarrësit e tjerë.

Çeqet e vlefshëm për t'u marrë nga banka marrëse, të cilat nuk janë marrë prej tyre në ditën e seancës së kleringut, për qëllime rregullimi dhe kthimi në kohë e duhur, do të konsiderohen si të dërguar në atë ditë dhe banka marrëse do të jetë përgjegjëse.

2.3 Përgatitja e dokumenteve para seancës

Para prezantimit në seancën e kleringut, banka dërguese ndjek procedurën për përgatitjen e dokumenteve të nevojshëm, si përcaktohet në Rregulloren Nr.83 datë 15/11/2006, neni 6.

Banka dërguese plotëson formularin për dërgimin e çeqeve në LEK në seancën e klerimit (në përputhje me Aneksin B.2) dhe dy persona të autorizuar (firma të autorizuar) e nënshkruajnë atë, në bazë të komunikimit që pjesëmarrësit kanë me njëri-tjetrin në përputhje me nenin 5, paragrafi 3, Rregullorja Nr.83 datë 15/11/2006.

3. Procedura e klerimit të çeqeve në lek

3.1 Zhvillimi i seancës së kleringut

Përfaqësuesit e autorizuar të pjesëmarrësve në seancën e klerimit të çeqeve shkëmbejnë midis tyre zarfet me çeqe.,.

Banka marrëse/dërguese kontrollon menjëherë çeqet, brenda ambienteve ku zhvillohet seanca e kleringut, për t'u siguruar që janë të rregullt. Në rast të konstatimit të parregullsive, pjesëmarrësit nuk i përfshijnë këto çeqe në llogaritjen e rezultatit të seancës.

Pas verifikimit të çeqeve, përfaqësuesit e autorizuar plotësojnë formularin përkatës për klerimin e çekut (shih Aneks B.3) në përputhje me llojin e çekut, bankar ose personal, me numrin e shumën e çeqeve të marrë, bazuar në informacionin e shkruar në anën e pasme të zarfit.

Në formularin e plotësuar, pjesëmarrësit llogarisin dhe shkruajnë shumën neto, për të cilën, debitohet ose kreditohet llogaria e shlyerjes (në sistemin AIPS/SETS) në Bankën e Shqipërisë, dhe më pas nënshkruajnë dhe dorëzojnë formularin e plotësuar tek drejtuesi i seancës së kleringut..

3.2 Rezultati dhe mbyllja e seancës së kleringut

Drejtuesi i seancës së kleringut të çeqeve plotëson formularin e instruksionit të shlyerjes neto (NSI) për të gjithë pjesëmarrësit, sipas llojit të çekut, bankar ose personal (shih Aneks B.4) dhe kontrollon nëse shuma e veprimeve të hedhura në Formularin B. 4 është e barabartë me zero.

Në rast se shuma e veprimeve të hedhur në Formularin B.4 nuk është e barabartë me zero, drejtuesi identifikon dhe korigjon gabimin në prani të përfaqësuesve të pjesëmarrësve. Drejtuesi i njeh përfaqësuesit e pjesëmarrësve me rezultatet neto të seancës së kleringut, deklaron të mbyllur seancën e kleringut të çeqeve dhe më pas nënshkruan Aneksin B. 4.

4. Shlyerja e rezultatit të seancës së kleringut në sistemin AIPS

Drejtuesi i seancës së kleringut, pas deklarimit të mbyllur të seancës, dorëzon instruksionet e shlyerjes neto (NSI) sipas Aneksi B. 4, me rezultatin e përfunduar të seancës së kleringut të plotësuar sipas paragrafit 3.2, pranë zyrës AIPS, për të vepruar në përputhje me procedurat dhe orarin operues të këtij sistemi (të përcaktuar në Vendimin Nr.12 datë 23/02/2011, Aneksi A – Orari operues i sistemit AIPS).

Njëkohësisht, drejtuesi përgatit dhe shpërndan dokumentet kontabël, për t'i dërguar ato tek bankat pjesëmarrëse nëpërmjet postës kontabël.

5. Përgjegjësia nga përgjegjësia

Banka e Shqipërisë nuk do të jetë përgjegjëse për humbjet që pëson një bankë në lidhje me pjesëmarrjen e saj në seancën e kleringut, me përjashtim të rasteve të neglizhencës ose mosdrejtimit të mirë të seancave së kleringut nga Banka e Shqipërisë

Përveç rasteve të parashikuara më lart, pjesëmarrësit në klering, nuk mbajnë përgjegjësi për dëmet e shkaktuara nga mospërbushja e detyrimeve të përcaktuar në këtë manual, që vijnë për shkak të deklarimit të situatave të paparashikuara, luftëra, manifestime, greva, trazira të tjera civile, fatkeqësi natyrore, çdo rrethanë tjetër jashtë kontrollit të tyre, ose për shkak të çdo force tjetër madhore.

Aneks B.1 Formulari i kërkesës për anëtarësim

Banka _____

K Ë R K E S Ë

Datë: _____

Nga: Banka _____

Për: Banka e Shqipërisë
Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Tiranë

Lënda: Anëtarësimi në kleringun ditor të çeqeve në lek

- 1) Pasi u njohëm me rregulloren “Për organizimin e kleringut të çeqeve në lek në Bankën e Shqipërisë, paraqesim kërkesën tonë për të marrë pjesë në shërbimin e kleringut të çeqeve në lek, organizuar nga Banka e Shqipërisë.
- 2) Gjithashtu, deklarojmë se jemi njohur dhe pranojmë marrëveshjet e lidhura që kanë për objekt veprimtarinë me çeqet në lek.
- 3) Ju njoftojmë emrat e përfaqësuesve të autorizuar në klerimin e çeqeve, si më poshtë:

Z. /Zj. _____

Z. /Zj. _____

Titullari

Emri Mbiemri, firma

Aneks B.2 Formulari për dërgimin e çeqeve në LEK në klering

Banka _____

DËRGIMI NË KLERING I ÇEQEVE: BANKAR PERSONAL

Datë _____

Banka _____ (pranuese)

Për Bankën _____ (lëshuese)

Nr.	Numri i çeqeve	Shuma në LEK
	Totali	

Shënim:

Nënshkrimi i autorizuar

Nënshkrimi i autorizuar

Emri Mbiemri, firma

Emri Mbiemri, firma

Aneks B.3 Formular i kleringut të çeqeve

Banka _____

Kleringu i çeqeve

BANKAR

PERSONAL

Data _____

Nr. i Llogarisë	Bankat pjesëmarrëse	Nr.	Shuam e sjellë (C)	Shuma e marrë (D)	Shuma neto

Nënshkrimi i përfaqësuesit në klering

Emër, Mbiemër, firma

Aneks B. 4 Instruksioni i Shlyerjes Neto

BANKA E SHQIPËRISË

Kliringu i çeqeve

BANKAR

PERSONAL

Date _____

Nr. i Llogarisë	Bankat Pjesëmarrëse	Neto për t'u debituar	Neto për t'u kredituar
	Totali		

Nënshkrimi i drejtuesit të seancës së kliringut

Emër Mbiemër, firma